

REGJIMI I SHITJEVE ME ANKAND

Objekti

Për shitjet në ankand të mallrave të përdorura, veprave të artit, objekteve të koleksionit apo të antikuareve të kryera nga organizatori i shitjes në ankand, për llogari të porositësit të shitjes në ankand, zbatohet një regjim i veçantë që lidhet me marzhin e realizuar nga organizatori i shitjeve me ankand.

Personat e tatueshëm

Ky regjim zbatohet për furnizimet e kryera nga organizatori i shitjeve me ankand, për llogari të porositësit të shitjes në ankand, i cili është njëri nga personat e mëposhtëm:

- a) personi që nuk është person i tatueshëm;
- b) personi i tatueshëm, nëse furnizimi i mallrave që ai kryen, mbi bazën e një kontrate komisioni, përjashtohet nga TVSH-ja sipas nenit 54, të këtij ligji, ose furnizon mallra, për të cilat nuk ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas nenit 74, të këtij ligji;
- c) personi i tatueshëm, subjekt i regjimit për bizneset e vogla, sipas përcaktimeve të seksionit 1, të kreut XI, të këtij ligji, furnizimi i mallit nga ana e të cilit është kryer mbi bazën e një kontrate komisionere për shitjen dhe ka të bëjë me mall kapital të përfshirë në aktivet afatgjata;
- ç) personi i tatueshëm rishitës, nëse furnizimi i mallit nga ana e këtij të fundit, i kryer mbi bazën e një kontrate komisionere për shitjen, i nënshtrohet TVSH-së në përputhje me regjimin e marzhit.

Momenti i furnizimit

Furnizimi i mallrave organizatorit të shitjes me ankand publik konsiderohet si i kryer në momentin kur realizohet shitja me ankand publik e këtyre mallrave.

Vlera e tatueshme

Vlera e tatueshme për furnizimin e mallrave nën këtë regjim përbëhet nga vlera totale që i faturohet blerësit ofertues më të mirë nga ana e organizatorit të shitjes me ankand, zvogëluar me vlerat e mëposhtme:

- a) vlera neto që organizatori i shitjes me ankand i ka paguar apo do t'i paguajë porositësit, e cila përbëhet nga diferenca midis çmimit të shitjes në ankand të mallit dhe vlerës së komisionit, që organizatori i shitjes në ankand ka marrë ose do të marrë prej porositësit, mbi bazën e kontratës komisionere për shitjen;
- b) vlera e TVSH-së për t'u paguar nga ana e organizatorit të shitjes me ankand për furnizimin e kryer.

Detyrime të faturimit ndaj blerësit

1. Organizatori i shitjes me ankand publik duhet t'i lëshojë blerësit një faturë, në të cilën dallohen veçmas elementet e mëposhtme:

a) çmimi i shitjes me ankand të mallit.

b) tatimet dhe taksat, taksat doganore, tarifat dhe të tjera të ngjashme.

c) shpenzime dytësore, si: komisione, shpenzime transporti, ambalazhimi, sigurimi etj. që organizatori ia ngarkon blerësit të mallit.

2. Në faturën e lëshuar nga organizatori i shitjes me ankand për blerësin nuk duhet të llogaritet apo të pasqyrohet e ndarë vlera e TVSH-së. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet shitjes me ankand organizatori i shitjes në ankand duhet të shënojë: "Shitje që i nënshtrohet regjimit të shitjes me ankand".

Detyrime të organizatorit ndaj porositësit të ankandit

1. Organizatori i shitjes në ankand, të cilit i është dorëzuar malli, mbi bazën e një kontrate komisioni për shitjen me ankand, duhet t'i paraqesë porositësit një pasqyrë të detajuar ku vlera neto, sipas nenit 141, shkronja "a", të këtij ligji, të detajohet si diferencë midis çmimit të shitjes së mallit në ankand dhe vlerës së komisionit për t'u marrë nga porositësi. 2. Pasqyra e hartuar sipas pikës 1, të këtij neni, zëvendëson faturën që porositësi, në rastin kur është person i tatueshëm, duhet të lëshojë, në momentin e kryerjes së furnizimit në përputhje me nenin 140, të këtij nënseksioni.

Mbajtja e llogarive kontabël

Ministri i Financave mund të përcaktojë me udhëzim dispozita të veçanta lidhur me mënyrën e mbajtjes së llogarive kontabël nga organizatori i shitjes me ankand për transaksionet e kryera në kuadër të shitjes në ankand.